



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivery	15.05.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	4245/2023		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.553/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.553/2023 të datës 23.03.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 15.05.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.553/2023 e datës 01.03.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. *Obligohet* Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshëm, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, ankuesit Shaip Dërmaku t'i bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-nënës, në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ (tutje referuar ankuesi), i punësuar në pozitën e punës Udhëheqës i Qendrës për Pajisje me Dokumente, në Agjencinë e Regjistrimit Civil, Zyra Regjionale në Kamenicë, me datë 01.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e plotësuar dhe ndryshuar përmes shkresës me numër protokolli 2935/2023 të datës 23.03.2023, kundër përgjigjes së datës 31.01.2023 të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme



me pretendimin se e njëjta është dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit me datë 14.04.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat ndërlidhur me këtë çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 4117/2023 të datës 05.05.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2935/2023 të datës 23.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 1309 të datës 28.02.2022; Certifikatën me numër V 10483064 të datës 28.02.2022 lidhur me vdekje e anëtarit të familjes; Deklaratën për bashkësi familjare të datës 14.10.2019; Ekstraktin e datës 28.02.2022 nga Regjistrimi i Qendror i Gjendjes Civile; Deklaratën për bashkësinë familjare të datës 26.07.2022; Emalin e datës 01.03.2023 të KPMSHCK-së drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 01.03.2023 të \_\_\_\_\_ drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 20.02.2023 të MPB drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 30.01.2023 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 27.01.2023 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 15.11.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 23.09.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 26.06.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 22.06.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 20.05.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 30.01.2023 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 27.01.2023 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 15.11.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 23.09.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 26.07.2022 të \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Emalin e datës 22.07.2022 të Sh.Dermaku drejtuar G.Ramadani; Emalin e datës 20.05.2022 të Sh. \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_; Kërkesën për përgjigje në ankesë e të datës 31.03.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 19.04.2023; Akt emërimin me Nr.ref.DRGJ/ARC-01/13 të datës 31.01.2013; Ndryshim plotësimin e akt emërimit të datës 30.11.2015; Emalin e datës 10.05.2023 të \_\_\_\_\_ drejtuar KPMSHCKS-ë; Vërtetimin me Nr.06 të datës 10.05.2023 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Lokal në Komunën e Kamenicës; Certifikatën e martesës me numër serik M1151740 të datës 11.01.2023 të lëshuar nga Zyrtari i autorizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Shkresën lidhur me aplikimin për mbylljen e shërbimeve bankare të datës 01.03.2023; Marrëveshjen për mbylljen e shërbimeve bankare të datës 05.11.2018; Ekstraktin nga rexhistrimi qendror i gjendjes civile me numër serik; E 26175106; Vendimin nën shenjen VK/2023 të datës 05.05.2023 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme dhe së i njëjti sipas Ndryshim dhe Plotësim të



Aktit të Emërimit të datës 30.11.2015 ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Qendrës për Pajisje me Dokumente*, në Zyrën Regjionale në Kamenicë.

Me tej nga shkresat e lëndës rezultoi se ankuesi më datë 28.02.2022, 20.05.2022, 22.07.2022, 26.07.2022, 23.09.2022 dhe 15.09.2022 kishte parashtruar kërkesë të organi i punësimit mbi bazën e kompensimit të një page mesatare për rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, gjegjësisht nënës së tij. Ankuesi serish me datë 27.01.2023 parashtroni kërkesë po me bazë të njëjtë, ndërsa organi i punësimit përkatësisht Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përgjigje të datës 30.01.2023 ka njoftuar ankuesin se: *“lidhur me kërkesën e datës 28.02.2022, zyrtari përgjegjës i personelit pa vonesë kishte përgatitur formularin për procedim të kërkesës së ankuesit të datës 28.02.2022, mirëpo, që Njësia për Buxhet nuk kishte aprovuar vazhdimin e mëtejshëm pasi që kjo kërkesë vlerësohej si e vjetërsuar”*.

Ankuesi pas përgjigjes së organit të punësimit të datës 30.01.2023, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mosveprimit të organit kompetent lidhur me aprovimin e kërkesës për kompensim të një page mesatare në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, dhe pretendimin ankimor se përgjigja e datës 31.01.2023 e organit të punësimit është në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet tjera, pasi që këto akte nuk parashohin afat të paraqitjes apo përfundimit të kërkesës lidhur me kompensimit në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozita të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 të ku përcaktohet se: *“1.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”, “2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”*, si dhe nenin 87 ku përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”* konstatoi se ankesa e ankuesit është e pranueshme, ngase sipas Certifikatës së Vdekjes V 10483064 të datës 28.02.2022, nëna e ankuesit tani e ndjera me inicialet ka ndërruar jetë më datë 13.02.2021, moment nga i cili ka filluar të rrjedhë afti i parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim material dhe së deri në parashtrimin e kërkesës së fundit të ankuesit me datë 27.01.2023 nuk kanë kaluar tri vite.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të aplikueshme në kohën e vdekjes së nënës së ankuesit, përkatësisht Kolegji i referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku me nenin 22 paragrafi 2 përcaktohej se: *2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ..2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil; si dhe dispozitave të nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ku parashihej se: ...2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzonte të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.*

Se kush përbënë familjen, Kolegji ju referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj*



1  
përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji. Lidhur me këtë fakt, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Nisur nga përcaktimi ligjor si me sipër, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10483064 të datës 28.02.2021, konstatohet se gjegjësisht nëna e ankuesit ka ndërruar jetë me datë 13.02.2021, kurse sipas Vërtetimit me numër 06 të datës 10.05.2023 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Lokal në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Kamenicës, është vërtetuar se ankuesi ka jetuar me nënën e tij deri në momentin e vdekjes e të ndjerës me datë 13.02.2021, kështu që, duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së nënës është i bazuar, ndërsa detyrohet organi i punësimit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.


Theksuar si me lartë e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e anëshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda më numër A.nr.553/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi dërgohet:**

- Ankuesit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.